

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Qershor 2017


**Tiranë, më 20 Korrik 2017:** Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Qershor 2017 është 816.877. Krahasuar me Qershor 2016, ky tregues rezulton me rritje 8,0 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 437.820, krahasuar me Qershor 2016, ky numër është rritur me 11,0 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në gjashtëmuajorin e parë 2017 është 1.759.294, duke u rritur me 9,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi gjatë muajit Qershor 2017 janë 771.980, duke shënuar një rritje me 5,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Qershor 2017 është 381.246. Krahasuar me Qershor 2016, ky numër është rritur 2,9 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në gjashtëmuajorin e parë 2017 është 2.263.581 duke u rritur 3,7 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Qershor 2017



Për publikim 20/07/2017

**Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, Qershor 2017**

Periudha	Qershor-16	Qershor-17	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Qershor 16	Janar-Qershor 17	Ndryshimi vjetor progresive (%)
<b>Hyrje Gjithsej</b>	<b>756.711</b>	<b>816.877</b>	<b>8,0</b>	<b>3.582.390</b>	<b>3.819.843</b>	<b>6,6</b>
Shqiptarë	362.350	379.057	4,6	1.981.695	2.060.549	4,0
Të Huaj	394.361	437.820	11,0	1.600.695	1.759.294	9,9
<b>Dalje Gjithsej</b>	<b>732.098</b>	<b>771.980</b>	<b>5,4</b>	<b>3.782.786</b>	<b>4.001.427</b>	<b>5,8</b>
Shqiptarë	370.622	381.246	2,9	2.183.251	2.263.581	3,7
Të Huaj	361.476	390.734	8,1	1.599.535	1.737.846	8,6

Numri i vizitorëve të huaj, të hyrë në Shqipëri për qëllime pushimi dhe vizita ditore në muajin Qershor 2017, rezulton 207.972, ndërsa në Qershor 2016 ky numër ishte 182.606 duke shënuar një rritje me rreth 13,9 %.

Në Shqipëri, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë për qëllime personale në Qershor 2017 është 430.702 dhe përbëjnë 98,4 %, të numrit gjithsej të hyrjeve të shtetasve të huaj. Krahasuar me Qershor 2016, numri i shtetasve të huaj për qëllime personale është rritur 11,0 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri për qëllime biznesi përbën 1,6 % të hyrjeve të shtetasve të huaj, duke shënuar një rritje prej 12,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit, Qershor 2017**

Periudha	Qershor-16	Qershor-17	Janar-Qershor-16	Janar-Qershor-17
<b>Hyrje Shtetas të Huaj</b>	<b>394.361</b>	<b>437.820</b>	<b>1.600.695</b>	<b>1.759.294</b>
I. Personale	388.042	430.702	1.573.820	1.727.180
1. Pushime	97.012	195.048	229.741	561.967
2. Vizitë në miq e të afërm	2.282	1.038	7.580	5.292
3. Vizitë ditore	85.594	12.924	221.186	39.217
4. Trajtim shëndetësor	88	15	385	259
5. Qëllime fetare	81	62	512	301
6. Vizitorë të tjerë	186.495	205.519	1.043.475	1.043.437
7. Udhëtarë tranzit	16.490	16.096	70.941	76.707
II. Biznes dhe profesionale	6.319	7.118	26.875	32.114


Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në muajin Qershor 2017, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej me 76,9 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore zënë 14,7 % dhe detare zënë 8,4 %.

**Tab.3 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit, Qershor 2017**

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Qershor - 16	98.523	49.688	608.500	83.853	43.744	604.501
Qershor - 17	119.849	69.116	627.912	104.364	61.666	605.950
Ndryshimi vjetor (%)	21,6	39,1	3,2	24,5	41,0	0,2
Janar-Qershor 2016	465.995	193.166	2.923.229	448.840	216.631	3.117.315
Janar-Qershor 2017	562.202	229.541	3.028.100	564.914	260.979	3.175.534
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	20,6	18,8	3,6	25,9	20,5	1,9

Numri më i madh i hyrjeve të shtetasve të huaj në vendin tonë, në muajin Qershor 2017 rezulton nga Kosova me 31,0 %, pasuar nga hyrjet e shtetasve të huaj nga Maqedonia me 12,1 %, Greqia me 9,2 % Itali 7,5 %, etj.

**Fig 2. Hyrjet sipas shteteve në Shqipëri**



# Metodologji

## Përkufizime

**Vizitorë:** Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet :** Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

*Kategoria e biznesit* përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>